



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. 1-03  
Br. \_\_\_\_\_

Data 15.01.2018  
Datum \_\_\_\_\_

OBILIQ-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Qeveria - Vlada - Government  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47 dhe 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 3.9 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI, mbledhja e III) me dt.24.01.2018 (e mërkurë) në ora 10:00, në sallën e re të Kuvendit komunal me këtë:

## REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbaleve nga mbledhja e kaluar
3. Formimi i Komiteteve obligative:
  - a) Komiteti për Politikë dhe Financa
  - b) Komiteti për komunitete
4. Formimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)
5. Propozimi i Kryetarit të Komunës për zgjedhjen e Nënkryetarit për komunitete
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

  
Burim Gërguri

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja inaguruese e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.21.12.2017, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Prezentë:** Burim Gërguri, Fatmir Bërbatovci, Enver Gashi, Florije Jashari, Agon Mjekiqi, Qëndresa Dubova, Shaip Paloja, Fatos Kurshumlija, Fatmir Bekteshi, Linda Sadiku, Arbnore Nasufi, Hysni Mjeku, Lulzim Sadiku, Samire Berisha, Aziz Bici, Xhezide Dragusha, Ajet Berisha, Nora Preniqi, Dragan Dancetovic, Nazmi Gashi dhe Slavisa Jakovljevic

**Prezentë:** Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, Naim Miftari, drejtor i administratës së përgjithshme, Ibush Mjekiqi, drejtor i DSHMS-së, Arben Berisha, drejtor i DMM-së, Zarife Behluli, drejtoreshë e DFEZH përf.e Policisë së Kosovës, përf.e KFOR-it, përf.e SHDL-së dhe qytetarë të tjerë

Mbledhjen e udhëhoqi anëtari më i vjetër i Kuvendit komunal z.Hysni Mjeku, i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

### REND DITE

10:00-10:15	Arritja dhe nënshkrimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe pjesëmarrësve tjerë
10:15-10:30	Fjala mirëseardhëse e Anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës (kryesues i mbledhjes)
10:30-10:45	Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës
10:45-11:00	Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës së Obiliqit z.Xhafer Gashi
11:00-11:15	Mbyllja e mbledhjes

**Naim Miftari** – të nderuar, para se të fillojmë seancën inaguruese, ju ftoj të gjithëve që të mbajmë 1 minut heshtje për kryesuesin e Kuvendit komunal, tashmë të ndjerin z.Adem Preniqi.

Të gjithë të pranishmit mbajtën 1 minut heshtje, për kryesuesin tani të ndjerin z.Adem Preniqi.


**Naim Miftari** – e përshëndes z.Xhafer Gashi dhe i uroj për zgjedhjen si Kryetar i Komunës për mandatin e ri. Poashtu, ju uroj të gjithë ansambleistëve zgjedhjen e tyre në këtë mandat duke ju dëshiruar punë të mbarë dhe suksese. Bazuar në LVL, këtë seancë duhet ta udhëheqë anëtari më i vjetër për nga mosha që në këtë rast është z.Hysni Mjeku, prandaj ftoj z.Hysni Mjeku që ta udhëheqë seancën.

**Hysni Mjeku** – fillimisht i uroj Kryetarit të Komunës z. Xhafer Gashit, për zgjedhjen e tij si Kryetar Komune dhe i uroj sukses në punën e institucionit komunal në Obiliq. Njëkohësisht ju uroj të gjithë ansambleistëve të zgjedhur nga vota e popullit që besimin e tyre ta materializojnë dhe fuqizojnë në interes të qytetarëve të Komunës tonë.

Të nderuar këshilltarë, para vetes keni deklaratën e betimit se të gjitha obligimet dhe detyrat që dalin nga ligji dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, do ti kryejmë me nder dhe me përkushtim të madh.

Tani, unë po e lexoj tekstin e deklaratës së betimit njëkohësisht bashkë me ju të gjithë të zgjedhur për mandatin e ri.

Pas kësaj, ansambleistët e zgjedhur nga vota e popullit dhanë betimin solemn për këshilltarë të Kuvendit komunal për mandatin e ardhshëm.



Dalës-izlazna

Nr.

1-104

Dt.

Data

21.12.2017

Datum

00110-00110



**Hysni Mjeku** - Pozvao gradonačelnika, Džafera Gašija za polaganje zakletve ispred odbornika Skupštine.

**Džafer Gaši** - je svečano dao zakletvu ispred odbornika Skupštine Opštine.

**Hysni Mjeku** Postoje smo formalizovali mandate, nas očekuju pravne obaveze i mnoge druge obaveze prema onima koji su nas izglasali. Pozivam gradonačelnika da preuzme reč.

**Džafer Gashi** - Poštovani članovi Skupštine opštine Obilić, predstavnici veterana rata, i KFOR-a, veoma poštovana porodica Prenić i prisutni drugi gosti. Najprije bih se zahvalio svima onima koji su radili 4 godine, počevši od već pokojnog predsednika, gosp. Adema Prenićija, koji je dao izvanredan doprinos u realizaciji svih projekata. Na žalost, kažem i osećam prazninu kao i svi opštinski zvaničnici, ali će uvek biti u našim sećanjima.

Postovani novi članovi Skupštine opštine, dozvolite mi da vam čestitam vas mandatu i želim vam dobar posao i uspeh u naredne 4 godine. Ova inauguralna sesija je početak ciklusa angažovanja, ozbiljnosti i značaja koji je dobijen aktom vaše zakletve. Ja, kao gradonačelnik, služiću u duhu saradnje sa svima vama, bez razlike i u naredne četiri godine, radićemo u duhu saradnje na svim temama od opšteg interesa. Kancelarija gradonačelnika će uvek biti otvorena za sve vas, bez razlike, jer samo koordiniranjem aktivnosti i obaveza možemo biti na usluzi svim građanima. Teme ispred nas su prevelike i teške i niko od nas neće imati alibi za neuspeh na kraju ovog mandata. Znajući brojne zahteve građana, kojima je potrebna velika ozbiljna posvećenosti u realizaciji svih projekata u ovom mandatu, a posebno primena Zakona o Obiliću, tražim posvećenost i doprinos svakog od vas. Ja sam jedan od vas i kao takav zahtevam da se pristupimo radu i govorimo istim jezikom, Jos jednom, čestitam vam mandate, želeći vam puno uspeha.

**Hysni Mjeku** - postovani učesnici i odbornici skupštine, sada zaključujemo inauguralni sastanak Skupštine opštine Obilić.

Sastanak se završen u 10:25'.

Stručno lice za posao SO  
opštine

  
Azize Zeneli

Predsedavajući Skupštine  
  
Hysni Mjeku  


## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.27.12.2017, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Prezentë:** Burim Gërguri, Fatmir Bërbatovci, Enver Gashi, Florije Jashari, Agon Mjekiqi, Qëndresa Dubova, Shaip Paloja, Fatos Kurshumlija, Fatmir Bektashi, Linda Sadiku, Arbnore Nasufi, Hysni Mjeku, Lulzim Sadiku, Samire Berisha, Aziz Bici, Xhezide Dragusha, Ajet Berisha, Nora Preniqi, Dragan Dancetovic, Nazmi Gashi dhe Slavisa Jakovljevic

**Prezentë:** Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, Naim Miftari, drejtor i administratës së përgjithshme, Ibush Mjekiqi, drejtor i DSHMS-së, Arben Berisha, drejtor i DMM-së, Zarife Behluli, drejtoreshë e DFEZH Përparim Klinaku, drejtor i DI-së, Enver Graiqevci, drejtor për infrastrukturë lokale, Drita Hashani, përf. e OSBE-së, përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi anëtari më i vjetër i Kuvendit komunal z.Hysni Mjeku, i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

### REND DITE

#### 1. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit komunal

**Hysni Mjeku** – i njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Aprovohet njëzërit rendi i ditës i cekur më lartë.

**Hysni Mjeku** – fillimisht konstatoj se të gjithë këshilltarët komunal janë prezentë në mbledhjen e jashtëzakonshme me vetëm një pikë në rendin e ditës dhe atë: “Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit komunal”. Tani të gjitha subjektet politike kanë të drejtë të propozojnë ndonjë kandidat për kryesues të Kuvendit komunal. Mirëpo, para se të propozohen kandidatët ne jemi të obliguar ta formojmë një Komision zgjedhor verifikues, i cili do të kujdeset për mbarëvajtjen e zgjedhjeve.

**Ajet Berisha** – është mirë në aspektin juridik dikush prej Ekzekutivit me na shpjegue lidhur me formimin e këtij Komisioni në rast se kryesuesit nuk i janë ofruar dokumentet e duhura. Pra, me na sqarue se cilët janë hapat që ne duhet ti ndjekim, çka thotë LVL-ja në mënyrë që kjo çështje të procedohet në bazë ligjore.

**Hysni Mjeku** – unë deshta të shkojmë më shkurtë sepse ne veç e njohim Udhëzimin administrativ për zgjedhjen e kryesuesit dhe LVL-në, por mbi të gjitha i takon zyrtares ligjore të japë sqarime.

**Drita Hashani** – sa i përket procedurës së zgjedhjes së kryesuesit të Kuvendit, në mënyrë shumë të qartë edhe kryesuesi tashmë e elaboroi. Ndërsa rreth formimit të Komisionit mund të propozohen 3-5 anëtarë nga radhët e anëtarëve të Kuvendit komunal sipas nenit 2, pika 4 e Udhëzimit administrativ nr.2009/1 për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

**Hysni Mjeku** – tani shkojmë me propozime së pari nga subjektet që kanë më shumë përfaqësues në Kuvendin komunal, pastaj subjektet tjera që vijnë me rend.


Nga radhët e AAK-së, Enver Gashi e propozon Agon Mjekiqin për anëtar të Komisionit.

Nga radhët e LDK-së, Shaip Paloja e propozon Fatos Kurshumliun.

Nga radhët e PDK-së, Lulzim Sadiku e propozon Samire Berishën.

Nga radhët e LB-së, Nora Preniqi propozon Ajet Berishën.

Nga radhët e LVV-së, Aziz Bici e propozon Xhezide Dragushën.



Dalës-Izleзна

Nr. 11-106  
Br.

Data 27.12.2017  
Datum

031110-081116



**Shaip Paloja** – më intereson forma e zgjedhjes së kryesuesit sepse askund në Statut nuk kam mund me gjetë që shkruan se kryesuesi zgjedhet me 2/3 e votave.Tani, a shkohet në 3 runde, apo me shumicën e votave.

**Hysni Mjeku** – përgjegjet se nëse, asnjëri kandidat nuk e merrë shumicën e votave dmth 11 vota, shkohet me shumicën e votave në rundin e dytë dhe nëse në rundin e dytë shkon me 11 vota, atëherë zgjedhet kryesuesi dhe s'ka 2/3 e votave.

Këshilltarët komunal u pajtuan njëzërit për përbërjen e cekur më lartë të Komisionit zgjedhor.

**Hysni Mjeku** – tani shkojmë me propozimet për kryesues të Kuvendit komunal.

**Agon Mjekiqi** – e propozon Burim Gërgurin për kryesues të Kuvendit komunal.

**Fatos Kurshumlja** – e propozon Shaip Palojin.

Tani, anëtarë t e Kuvendit komunal votojnë me vota të fshehta për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit komunal.

Pas kësaj, Komisioni zgjedhor filloi punën duke verifikuar dhe numruar 21 fletëvotime me votat e fshehta të këshilltarëve komunal dhe me 12 vota “Për” (Burim Gërgurin) 8 vota “Për” (Shaip Paloja) ndërsa 1 votë e pavlefshme merret:

## V E N D I M

### Zgjedhet Burim Gërguri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit.

**Hysni Mjeku** – tani i uroj kryesuesit të posa zgjedhur të Kuvendit komunal punë të mbarë, suksese njëherit e ftoj që ta merrë edhe fjalën. Poashtu, të gjithë të pranishmëve ju uroj festat e fundvitit dhe suksese.

**Burim Gërguri** – të nderuar të gjithë ju që jeni prezentë në këtë sallë, unë jashtëzakonisht ndjem i privilegjuar që jam në mesin tuaj dhe ju përgëzoj të gjithëve për një proces të rregullt zgjedhor. Urime për të gjithë, për të zgjedhurit në këtë mandat dhe një dedikim i veçantë ndoshta do të shkoj për ish kryesuesin e këtij Kuvendi, kolegun, mikun tonë të ndjerin z.Adem Preniqi i cili vërtetë po na mungon në këtë seancë. Lavdi, i qoftë jetës dhe veprës së tij.

Unë i përgëzoj të gjithë ata që më votuat dhe që ishin kundër sepse kjo është pjesë e demokracisë. E falenderoj Kryetarin e Komunës, që për 4 vite që ishim bashkarisht rrugëtuan me shumë sfida, por me një angazhim e besim që e kisha prej Kryetarit, unë ndoshta isha një ndër njerëzit më të privilegjuar në Komunën e Obiliqit, vetëm për një arsye se mbuloja sektorin më të rëndësishëm dhe poashtu udhëheqja edhe zyrën për informim. Unë nga kjo foltore ju garantoj për besimin që ma dhatë se do të mundohem të punoj në bazë të LVL-së dhe ligjeve tjera në fuqi.

**Mbledhja përfundoi në ora 10:40'**

Bashk.prof.për punë të KK

  
Azize Zeneli



Kryesuesi i Kuvendit komunal

  
Hysni Mjeku